



103

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 12B prot.Vlorë, më 20.01 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2026

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET
E BUXHETIT VENDOR.**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 9 pika 1/a, pika 1/b neni 30 pika 6 dhe 7 neni 54, pika k dhe n neni 24, Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, Vendimin nr 617 datë 22.9.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr 597 datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave” Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike “të ndryshuar Udhëzimin nr. 5 datë 17.02.2017, pika 1 dhe 4, “Mbi përdorimin e fondit të kushtezuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” i ministrit së përkatëse, “si dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Këshilli i Bashkisë .

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtezuar dhe nga fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën si dhe të jetë kryer paraprakisht vlerësimi socio-ekonomik në familje si më poshtë:
 - a. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi digjital i pikëzimit për mos paraqitje tek zyra e punës për qytetarët në moshë afër pensionit në kushte të vështira ekonomike, për mos gjenerim të deklaratës tremujore, për mos tërheqje të ndihmës mujore, për arësye shëndetsore, fatkeqësi familjare e të tjera.
 - b. Familje me probleme të thella sociale që nuk mund të realizojnë proceset gjyqësore për zgjidhje martesë dhe vendimet për UMM.
 - c. Familje ekstremisht të varfëra që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin.

- d. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/sëmundje të rënda të cilat nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushte të vështira socio-ekonomike.
 - e. Familje që kanë në përbërje fëmije të braktisur nga prindrit dhe që jetojnë aktualisht te gjyshërit ose të afërm të tjerë.
- 2. Familjet me kriteret e mësipërme të jenë të justifikuara me dokumentacion përkatës.
 - 3. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas Vendimit nr 617 datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike “të ndryshuar.
 - 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar - Buxhetit dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social .
 - 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6 .

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 1213 prot.

Vlorë, më 20.01 2026

R E L A C I O N

mbi

PROJEKTVENDIMIN

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET
E BUXHETIT VENDOR**

Familjet me të ardhura të pamjaftueshme dhe në kushte të vështira social-ekonomike, të cilat kanë dalë me pikë të pamjaftueshme ose janë përjashtuar nga sistemi i pikezimit digjital të cilat nuk plotësojnë kriteret sipas Ligjit nr. 57 dt. 18.07.2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në VKB nr.100 datë 23.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2026”, administratorët shoqëror pranë rajoneve dhe njësive administrative dhe grupi i punonjësve sociale në Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social të cilët bëjnë vleresimet socio-ekonomike në familjet që aplikojnë çdo muaj dhe pretendojnë të jenë fitues në sistemin digjital por që nuk i plotësojnë kriteret sipas legjislacionit rekomandohen kriteret specifike të sipërpërmendura.

Konceptoi: *K. Billa*

Drejtore i Ndihmës dhe Shërbimit Social

Irena Stasa